



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.  
DREJTORIA E PROKURIMEVE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE



**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: 1.Operatorin ekonomik “Noa Control”sh.p.k

Adresa Tiranë,Njësia Bashkiake nr,5,Rruga Nikolla Tupe,Ndërtesa nr,3,kati 1,nr.1

2. Operatorin ekonomik “Metro-Alb 12” sh.p.k

Adresa Tiranë,Njësia Bashkiake nr,7,Rruga 29 nëntori ,Ndërtesa nr,31,kodi postar  
1026.

Procedura e prokurimit:”E Hapur-Shërbime.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF- 02326-12-27-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbim Verifikim dhe Vulosja e Matësave” me fond limit 15.668.946,67(pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e dyzetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë)lekë pa tvsh me afat 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X (Shuma totale e çmimeve për njësi)**  
oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Noa Control”sh.p.k

L51622005C

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shuma totale e çmimeve për njësi 1350(një mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.

2. "Metro-Alb 12" sh.p.k  
*Emri i plotë i shoqërisë*

L24211001V  
*numri i NIPT-it*

Shuma totale e çmimeve për njësi 1355 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

3. BO "Metro-Mad" sh.p.k  
*Emri i plotë i shoqërisë*

& K.P.K sh.p.k

*numri i NIPT-it*

L51808031T

&

J73721017E

Shuma totale e çmimeve për njësi 1375 (një mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. BO "Metro-Mad" sh.p.k  
*Emri i plotë i shoqërisë*

& K.P.K sh.p.k

*numri i NIPT-it*

L51808031T

&

J73721017E

Shuma totale e çmimeve për njësi 1375 (një mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 3.3. është kërkuar ....

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë 3 viteve të fundit (nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë jo më pak se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose 4,700,684 (katër milion e shtatëqind mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.*

*- Kur shërbimi i ngjashëm i mëparshëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.*

*- Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat, shuma, lloji i shërbimit, të nënshkruar nga të dyja palët*

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh KVO konstaton se operatorët kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së lidhur para një noteri publik datë 10.01.2019, nr.28 Rep nr.25/1 kol.

Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se referuar "rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar mbi zbatimin e objektit "Shërbim Verifikimi dhe Vulosja

e Matësive” ndër të cilat kanë ndarë përqindjen e pjesëmarrjes së shërbimit dhe ndarjen e elementëve konkretë që do të kryejë secili prej operatorëve ekonomikë.

Referuar kontratës së bashkëpunimit së paraqitur KVO vëren se operatori ekonomik Medro-Mad sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 70% të kryerjes së shërbimit ndërsa operatori ekonomik K.P.K sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 30% të shërbimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik përkatësisht nga operatori ekonomik K.P.K sh.p.k konstatohet se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar se ka kryer shërbime të ngjashme ashtu siç është kërkuar në pikën 3.3 DST.

KVO citon se në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar shprehimisht parashikohet se : “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*

Referuar bazës ligjore së mësipërme operatori ekonomik KPK sh.p.k ka qënë i detyruar të paraqiste kontratë të ngjashme për procedurën objekt prokurimi në përputhje me përqindjen që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Nëse ju do të kishit paqartësi mbi vendosjen e kriterit të sipërpërmendur mbi vendosjen e kriterëve keni pasur momentin procedural të parashikuar në nenin 42 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik në të cilën shprehimisht citohet se...

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Evidentimi i mungesës së dokumentacionit të kërkuar në DST KVO konkludon se operatori nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe legjislacionit në fuqi dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Ne rregullat e prokurimit publik theksohet se , operatorët janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe **paraqesin të plote të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DT .**

Moplotësimi qofte edhe i nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim .

Në shtojcën 8 shprehimisht parashikohet se... **Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Në këto kushte KVO është e detyruar të zbatojë nenin 55/2 të parashikuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006”Për Prokurimin Publik”në të cilën shprehimisht parashikohet se....

**Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.**

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës I;

Gjatë shqyrtimit të ofertës (shumës totale të çmimeve për njësi) së paraqitur nga operatorët ekonomikë në sistemin elektronik KVO evidenton se operatorët kanë tejkalluar fondin limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi. Sqarojmë operatorët ekonomikë se janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi në rast se nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta do të refuzohen si të papranueshme, sikurse është parashikuar në pikën II, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1, të Dokumentave standarte të Tenderit

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi kanë tejkalluar fondin limit si dhe nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Noa Control”sh.p.k

L51622005C

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shuma totale e çmimeve për njësi 1350(një mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.

2.”Metro-Alb 12” sh.p.k

L24211001V

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shuma totale e çmimeve për njësi 1355(një mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë)lekë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.01.2019.

Ankesa: JO